



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1359 Prot.

Tiranë, më 01.07 2026

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 98 dt. 01.07 2026

**“PËR MIRATIMIN E HAPJERS SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE NË “REHABILITIM TË PROFESIONEVE TË SHËNDETIT”
MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETIT TË
SHKENCAVE TË REHABILITIMIT” DHE UNIVERSITETIT “MAGNA GRECIA” TË
KATANXAROS NË ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, vendimin nr.310 datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, Vendimin Qarkullues të Rektoratit nr. 89 datë 01.07.2026, shkresën e Ministrisë së Arsimit nr.5049 Prot., datë 30.06.2026 “Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve”, shkresën nr. 76/9 prot., datë 01.07.2026 të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit “Përcjellje për miratim të Rregullores së programit të përbashkët të studimit Master i shkencave në “Rehabilitimi të profesioneve të shëndetit”, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit Master i shkencave në “Rehabilitim të profesioneve të shëndetit”.
2. Programi i përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze.
3. Kodi i programit të përbashkët të studimit është P72MS0915I (shkresa bashkëlidhur).
4. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit të UST-së, Bordit të Administrimit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK SHQIPËRISE

Prof. Dr. Agron KAS

